

STATUTI I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "DERMOTECH" SHPK

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Sot, më datë 18/03/2024, në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë, Ortakët themelues:

- Znj. Polina Laro, lindur më 16.09.1993, në Durrës madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BE1432009.
- Znj. Maris Garori, lindur më 29/12/1992 në Durrës madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034516294.
- Z. Erbi Ago, lindur më 08/03/1990 në Tiranë. madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036752440.

si themelues të kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosën të hartojnë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtme:

NENI 2

EMRI DHE EMËRTIMI TREGTAR

2.1 Emri i shoqërisë është "DERMOTECH" shpk.

2.2 Emërtimi tregtar i shoqërisë është DERMOTECH.

NENI 3

FORMA

3.1 Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara për kapitalin.

NENI 4

SELIA

4.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: "Rruga Sul Bega, Nr. Pasurie 6/314-G2 Zona Kadastrale 8370, Tiranë".

4.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.



4.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Me vendim të Administratorit mund të hapen degë dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 5 AFATI

5.1 Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

NENI 6 OBJEKTI

6.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Të zhvillojë aktivitet në fushën e importit-eksportit dhe tregëtimit të pajisjeve estetike. Tregëtim i produkteve estetike të përdorura përgjatë dhe pas procesit të trajtimit estetik me pajisjet e tregëtueshme. Organizim të trajnimeve për përdorimin e pajisjeve estetike.

NENI 7 KAPITALI

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000(pesëqind mijë) Lekë. Ortakët Themelues kanë kontribuar në kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Znj. Polina Laro, kontribuon në Kapitalin Themeltar të shoqërisë me vlerën 225,000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) Lekë;
- Znj. Maris Garori, kontribuon në Kapitalin Themeltar të shoqërisë me vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë që i përket 10 % të vlerës së kapitalit;
- Z. Erbi Ago, kontribuon në Kapitalin Themeltar të shoqërisë me vlerë 225,000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) Lekë që i përket 45 % të vlerës së kapitalit;

7.2 Kapitali Themeltar i shoqërisë "DERMOTECH"shpk përbëhet nga 3 (tre) kuota, nga 1(një) kuotë për secilin ortak:

- Znj. Polina Laro, zotëruese e 1(një) kuote, me vlerë 225,000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) Lekë e cila përfaqëson 45 % të shoqërisë;
- Znj. Maris Garori, zotëruese i 1(një) kuote, me vlerë vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë e cila përfaqëson 10 % të shoqërisë;
- Z. Erbi Ago, zotërues i 1(një) kuote, me vlerë 225,000 (dyqind e njëzet e pesë mijë) Lekë e cila përfaqëson 45 % të shoqërisë.

7.3 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 KUOTAT E KAPITALIT

8.1 Kuota mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

8.2 Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen,

nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

- 8.3 Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.
- 8.4 Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

NENI 9

MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

- 9.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që do t'ju ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.
- 9.3 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

NENI 10

ORGANET E SHOQËRISË

- 10.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë :
- Asambleja e Përgjithshme;
 - Administratori.
- 10.2 Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 11

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

KOMPETENCAT

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit;

- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 12

MBLEDHJA E ASAMBLESË

- 12.1 Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 13

THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

- 13.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 13.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 13.3 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.
- 13.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Për emërimin e administratorit Asambleja vendos sipas pikës 15.1 të nenit 15 të këtij statuti.

- 13.6 Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal, i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 13.7 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëpërmjet komunikimeve me shkrim, faks, postë elektronike dhe shërbime postare. Një vendim i Asamblese së Përgjithshme mund të merret përmes qarkullimit të dokumenteve të shkruar, dhe si pasojë pra pa nevojën e mbajtjes së një mbledhjeje në një adresë fizike. Adresat Zyrtare të komunikimit me e-mail janë : për znj. Polina Laro customerservice@panaceagroup.al për znj. Maris Garori marisgarori@gmail.com , për z. Erbi Ago erbi.ago@gmail.com .
- 13.8 Ortakët që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, marrin pjesë dhe votojnë me komunikim të ndërsjelltë (tele-konferencë) në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

NENI 14

ORGANI ADMINISTRATIV

- 14.1 Administratorët pa kufizime të shoqërisë janë:
- Znj. Polina Laro i mbajtëse e pasaportës me nr. BE1432009.
 - Z. Erbi Ago mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036752440.

NENI 15

KOMPETENCAT

- 15.1 Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos me 1/2 e votave të ortakëve pjesëmarrës për emërimin e administratorit. Vendimi për emërim është i vlefshëm nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 15.3 Administratori ka këto kompetenca:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë

- tregtare;
h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

- 15.4 Administratori është kompetent edhe për të:
- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.
- 15.5 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 16 PRISHJA E SHOQËRISË

- 16.1 Shoqëria priset:
- a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - b) në rast se objekti bëhet i paralizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar
 - c) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - d) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 16.2 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes së likuidimit emrit të shoqërië i shtohet pjesa "Në likuidim" që shënohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjatë kësaj periudhe.
- 16.3 Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Përgjithshme, kërkon ç' regjistrimin e shoqërisë pranë QKB, pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura të shoqërisë.

NENI 17 VITI FINANCIAR

- 17.1 Në përputhje me ligjin, shoqëria do të ketë një regjistër në të cilin mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

NENI 18

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 Janar të çdo viti kalendatarik dhe përfundon në 31 Dhjetor të po këtij viti, me përjashtim të vitit të regjistrimit, ku viti financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 dhjetor.

NENI 19 DIVIDENTËT

19.1 Pas miratimit të bilancit vjetor dhe përcaktimit të destinimit të fitimit, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividendë, bazuar në kuotat që zotëron çdo ortak.

NENI 20
PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE

- 20.1 Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 20.2 Shoqëria ka vulën e saj në të cilën shkruhet emri i shoqërisë sic e parashikon ligji.
- 20.3 Për ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit.


Statuti është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale me të njejtën fuqi ligjore.

ORTAKËT THEMELUES

Polina Laro

Polina Laro


Erbi Ago

ERBI AGO


Maris Garori

Maris Garori
